

Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

Për :	Bali Muharremaj, Kryetar i Komunës së Suharekës Bexhet Kuçi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Suharekës	
Cc:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Adrijana Hodžić, Ministre e MAPL-së Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së	
Nga:	Xhevat Tafa, U.D i Drejtorit të Departamentit Ligjor dhe Monitorimit të Komunave MAPL	Datë: 08/07 /2019 Nr. 020-765
Lënda:	Konfirmimi i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Suharekës	
Lloji i aktit:	<input type="checkbox"/> Vendim	

I nderuar Kryetar,

I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/2016 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim Nr. 016-41942 për formimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave të palëve të pakënaqura në lidhje me dhënien në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës se paluajtshme të komunës

I miratuar më datë: 27.06.2019

I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 02.07.2019

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit të komunës së lart cekur, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejme në lidhje me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës


Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration



Za :	Bali Muharremaj, gradonačelnik Opštine Suva Reka Bexhet Kuçi, predsedavajući Skupštine opštine Suva Reka	
Cc:	Jedinici za administraciju dokumenata u MALS-u Jedinici za administraciju dokumenata u opštini	
Preko:	Adrijana Hodžić, ministarka MALS-a Rozafa Ukimeraj, generalna sekretarka MALS-a	
Od:	Xhevat Tafa, v.d rukovodioca Pravnog odeljenja i monitorisanje opština /MALS	Datum, 08.07.2019.
Predmet:	Potvrda zakonitosti odluke Skupštine opštine Suva Reka	Br. 020-765
Vrsta odluke:	Odluka Skupštine opštine	

Uvaženi gradonačelnice,

Uvaženi predsedavajući,

U saglasnosti sa uredbom Vlade Republike Kosova br. 01/2016 za administrativno razmatranje akata opština i na osnovu zakonskih ovlašćenja određenim osnovnim zakonima i Uredbom Vlade br. 02/2011 o poljima odgovornosti administrativne Kancelarije premijera i ministarstva, Odeljenje za zakonska pitanja i monitorisanje opština MALS-a, primio je za obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

Odluka br. 016-41942 o osnivanju komisije za razmatranje žalbi nezadovoljnih stranaka u vezi sa odobravanjem kratkoročne i dugoročne upotrebe opštinske nepokretne imovine
Usvojena dana, 27.06.2019. godine,
Predložena za razmatranje u MALS-u dana, 02.07.2019. godine,

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine, procenjuje da je opštinski akt u proceduralnom aspektu u saglasnosti sa **zakonskim odredbama zakonodavstva na snazi** i kao takav može proizvesti pravni učinak.

Ministarsvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštini za dodatna objašnjenja u vezi sa ovom procenom.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË
MUNICIPAL OF ASSEMBLY- SUHAREKA
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA



Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, shkronja (c), të Ligjit Nr. 03/L-040, për Veçqeverisjen Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008), neneve 15, 29, pika 2 të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, e në mbështetje të nenit 18, paragrafi 1, lidhur me paragrafin 2, të Ligjit Nr. 06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 40/2019", Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datë, 27.06.2019,

Kuvendi i Komunës së Suharekës			
Punëtori i Punëve të Përbashkëta			
Municipal Government Administration			
Date: 02.07.2019			
Kodi: -07-020 765			

V E N D I M
Për formimin e komisionit

Neni 1

Formohet komisioni për shqyrtimin e ankesave që paraqiten nga palët e pakënaqur ofertuese, pas procesit të vlerësimit final të ofertave të përzgjedhura nga ana e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës.

Neni 2

Komisioni nga neni 1, (një) i këtij vendimi përbëhet prej 5, (pesë) anëtarëve dhe do të ketë përbërjen:

- 2.1 Shekter KOLGECI-----përfaqësues nga Kuvendi i Komunës **LOK**
- 2.2 Florije BYTYQI-----përfaqësuese nga Kuvendi i Komunës **PDK**
- 2.3 Sanie KUQI-----përfaqësuese nga Ekzekutivi i Komunës
- 2.4 Enver SHABANI-----përfaqësues nga Ekzekutivi i Komunës
- 2.5 Saranda BAJRAKTARI-----përfaqësuese nga sektori jo qeveritar

Neni 3

Detyrat dhe përgjegjësit e komisionit janë që të bëjë shqyrtimin e ankesave që paraqiten nga palët e pakënaqur ofertuese, pas procesit të vlerësimit final të ofertave të përzgjedhura nga ana e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës, ku komisioni lidhur me ankimin vendosi me vendim në këtë mënyrë:

- 3.1 refuzimin e ankesës dhe lënia në fuqi të procesit të vlerësimit final të ofertës
- 3.2 miratimin e ankesës dhe shfaqizimin, revokimin e procesit të vlerësimit final të ofertës.

Neni 4

4.1 Per punën që do ta kryej komision do të kompensohen nga 50€, për çdo mbledhje (seancë) që do ta mbajë, pagesa bëhet nga mjetet vetanake të Komunës në Suharekë.

4.2 Anëtarët e komisionit të lartcekur nuk mund të paguhen më shumë se 6, (gjashtë) mbledhje (seanca) të cilat mbahen brenda viti kalendarik.

Neni 5

5.1 Mandati i anëtarëve të Komisionit të ankesave është 2 (dy) vite brenda mandatit të Kuvendit të Komunës në Suharekë.

5.2 Kuvendi i Komunës në Suharekë, e ruan të drejtën ekskluzive të ndryshimit dhe plotësimit të anëtarëve të komisionit kur do herë që kërkohet.

Neni 6

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit mbi veçqeverisjen lokale, Nr.03/L-040, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008", nenit 8, të Rregullores (QRK), Nr. 01/2016, për shqyrtimin administrativ të akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen e Komunës.

Neni 7

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi me numër, 01-Nr-020-8563, i datës 26.02.2018, për formimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave.

KUVENDI KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr. 016-41942
Me datë 28.06.2019

Kryesuesi Kuvendit
10-1
Bexhet KUÇI